





Përmbajtja

- I. “Aktivizo objektet.
Aktivizo kujtimet.
Aktivizo të ardhmet alternative.”
Nga Thomas Oberender
- II. Farë e Çuditshme
— Pamjet e Ekspozitës
- III. “Një Galeri Pa Mure
dhe Një Shtet Pa Territor”
nga Inke Arns
- IV. Bisedë
me Albert Allgaier
- V. Performancat si prapavijë e
objekteve në “Strange Seed”
- VI. Rreth artistit

Contents

- | | | |
|------|---|---------|
| I. | “Activate objects.
Activate memories.
Activate alternative futures.”
By Thomas Oberender | 06 — 13 |
| II. | Strange Seed
— Exhibition views | 18 — 45 |
| III. | “A Gallery Without Walls
and a State Without Territory”
By Inke Arns | 46 — 55 |
| IV. | Conversation
with Albert Allgaier | 56 — 69 |
| V. | Performances as the hinterland
of the objects in “Strange Seed” | 70 — 89 |
| VI. | About the artist | 90 — 93 |

KOSOVO
MENT
HE SPORTT
INE I SPORTA
AND SPORT
KOSOVES
KOSOVA
OF KOSOVO

KARIZES

1. Karizet e Koshovës janë ndërtuar nga populli dhe janë njëherit monumente kulturore dhe teknologjike.
2. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
3. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
4. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
5. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
6. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
7. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
8. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
9. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.
10. Ata janë njëherit shprehje të kulturës dhe të teknikës së ndërtimit të lashtë.





01

Foto/Photo:
Atdhe Mulla

“Aktivizo objektet. Aktivizo kujtimet. Aktivizo të ardhmet alternative.”

nga Thomas Oberender

Veprat e Fatmir Mustafa-Karlos ftojnë audiencën të angazhohet, jo në kuptimin e artit si një ekran ku projektohen përvoja private, por si dëshmi që gdhendet në material. Për më shumë se dy dekada, shumë prej veprave të tij janë ndërlidhur me performanca dhe intervenime, të cilat i riformësojnë hapësirat dhe proceset shoqërore dhe i lidhin ato me perspektiva alternative. Punimet e prezentuara në “Strange Seed” janë situative, në radhë të parë në raport me hapësirat konkrete historike dhe ato publike, prej të cilave buron materiali i përdorur dhe të cilave edhe u referohet në të njëjtën kohë. Rrobat mbrojtëse të punës, asfalti e dokumente historike - këto janë farat e çuditshme të cilat artisti i përcjellë me kalimin e kohës dhe të cilat i përfshin në veprat e tij si forma rebeluese dhe alternative të kujtesës. Farat janë sende dhe në të njëjtën kohë edhe burim i proceseve jetësore. Si fruta janë ushqim, pra diçka që prodhohet dhe shitet si produkt bujqësor. Njëkohësisht, çdo farë është imazh i një potenciali të pastër, i një burimi të fjetur të zhvillimit, rritjes dhe jetës. Farat e çuditshme janë këto frutat e pazakonta ose që thjesht mund të duken të çuditshme në kontekstin e tyre. Si një devijim i papritur ose i paqëllim, ato krijojnë një pikëpamje divergjente të rregullave. Kësisoj, vëmendja që ato marrin e anormalizon realitetin duke i dhënë dukshmëri asaj që anashkalohe.

Activate objects. Activate memories. Activate alternative futures.

by Thomas Oberender

I.

Fatmir Mustafa - Karlo's works are engaged, not in the sense of art as a projection screen for private experience, but as a witness inscribed in the material. For a good two decades, many of his works have been related to his performances and interventions, which reframe spaces and social processes and connect them with an alternative perspective. The works presented in the exhibition "Strange Seed" are situational, primarily in relation to concrete historical spaces and public places, from which the material used originates and to which it simultaneously refers. Protective work clothing, asphalt, historical documents - these are the strange seeds that the artist passes on through time and incorporates into his work as a rebellious and alternative form of memory.

At the same time, seeds are both things and the source of vital processes. As fruit, they are food, something that is produced and sold as an agricultural product. And at the same time, every seed is an image of pure potentiality, a latent source of development, growth, life. Strange seeds are those fruits that are out of the ordinary or simply seem strange in their context.

As an unexpected or unintentional deviation, they create a divergent view of the rule. The attention they attract de-normalizes reality and makes the overlooked visible.

06 - 07

Disa nga objektet që i shohim në ekspozitë burojnë ose nga proceset performuese ose i dokumentojnë ato – pecetat e bardha me djersë të fuqisë punëtore nëpër rrugët e Elbasanit, të cilët punëtorët i përdornin për t'i fshirë djersët gjatë takimit me artistin. Tjetri rast është busti i mermerit i artistit Elvis Presley, i cili i referohet performancës “Anyways, Always” të vitit 2011-2012 i zhvilluar në një stacion social finlandez, i cili në “Strange Seed” dokumentohet në disa seri fotografish.

Skulpturat prej neoni “It’s Difficult, You Better Stop it” poashtu ndërlidhen me performancat në të cilat Karlo reflekton për gjendjen e artistit dhe marrëdhënien mes artit dhe tregut të artit, përfshirë veprat si “Meeting the Curator” (2007) dhe instalacionin e tij “The accidents of Rose’s” (2008) në projektin “Dyqani i Berberit” të kuruar nga Sislej Xhafa në Prishtinë. Në këtë vepër, vizitori ulet në karrigën e berberit, përballë pasqyrës, përpara së cilës portreti i një kuratori të shquar qëndron i varur me fije të perit në tavan. Skulptura “The Artist Must Stand” e cila e hapë ekspozitën “Strange Seed” është poashtu pjesë e këtij kompleksi të veprave të tij.

Një situatë specifike, që lidhet me perceptimin, poashtu haset në ekspozitën me veprat si piktura “Rapid Eye Movement” sipërfaqja e qelqit e të cilës, e ndërtuar prej materialeve të ndryshme, i pasqyron në mënyrë të thyer vizitorët në galeri. Ndërkaq, dhomat e bardha dhe të errëta nga seria “The History of Misery” ku vizitorët i shohin mbishkrimet fosforeshente duke e përdorur dritën e telefonave të tyre, poashtu synojnë të krijojnë një përjetim të pazakontë.

Ashtu si në skulpturën “The Artist Must Stand”, shumica e veprave të Karlos janë të dizajnuar asisoj që ta tërheqin shikuesin përbrenda hapësirës së veprës, duke u lënë shpesh një përvojë të ëmbël dhe të thartë: A vërtet mund të ecësh mbi një tepih me rroba pune? Çfarë arome kanë ato leckat e bardha në kutinë e madhe prej xhami?

Shumë prej veprave të Karlos e zhvillojnë një koncept skulpturor të materialeve të cilat janë specifike për vendet konkrete prej nga vijnë dhe të cilave u referohen. Në objektet e gjetura si pllakat e asfaltit, dokumentet historike dhe boshllëkun e pluhurosur të ndërtesave të dikurshme të fabrikës, apo edhe mbishkrimet e të burgosurve, artisti arrin t'i zbulojë proceset politike dhe faktet individuale të këtyre proceseve. Veprat si kutitë e dritave të serisë “The Moon” ose pamjet e asfalteve të “Nightmare” i sjellin materialet në një formë serike që i abstrakton objektet e gjetura. Këto materiale, thyhen deri në pluhur në serinë “Rapid Eye Movement”, transformohen në panele me ngjyra të shndritshme si në kutitë e “The Moon” ose përpunohen si pjesë uniforme individuale e rrobave

Some of the objects shown in the exhibition originate from or document performative processes - the white sweat towels used by workers and laborer's on the streets of Elbasan to dry themselves during their encounters with the artist, or the marble bust of the artist as Elvis Presley, referring to his 2011-2012 performance "Anyways, Always" in a Finnish social station, documented in "Strange Seed" in several photo series.

The neon sculptures "It's difficult" and "You better stop it" are also linked to performances in which Karlo reflects on the situation of the artist and the relationship between art and the art market, including actions such as "Meet the Curator" (2007) or Karlo's installation "The accidents of Rose's" (2008) in the "Barber Shop" project curated by Sislej Xhafa in Pristina. Here, the visitor sat in a barber's chair facing a mirror in front of which portraits of a prominent curator were suspended from the ceiling by threads. The sculpture "The Artist Must Stand", which opens the exhibition "Strange Seed", is also part of this complex of works.

A specific perceptual situation is also created in the exhibition by works such as the painting "Rapid Eye Movement", whose glass surface, composed of various materials, reflects the viewers in the gallery in a fractured way. The white and dark rooms from the series "History of Misery", in which visitors can discover the phosphorescent inscriptions of the prisoners with the light of their smartphones, also aim to create an unusual experience.

As in the sculpture "The Artist Must Stand", many of Karlo's works are designed to draw the viewer into the space of the work, often leaving a sweet and sour experience: Can you really walk on a carpet of work clothes? What is the scent of those airy white cloths in the large glass box?

Many of Karlo's works develop a sculptural concept of materials that are specific to the concrete places from which they come and to which they refer. In found objects such as asphalt slabs, historical documents and the dusty emptiness of former factory buildings, or the inscriptions of prisoners, the artist discovers the political processes and individual destinies they contain. Works such as the light boxes of the "Moon" series or the asphalt images of the "Nightmare" group bring the material into a serial form that abstracts the found object, crushing it into dust as in the "Rapid Eye Movement" series, transforming it into luminous panels of colour as in the "Moon" boxes, or processing the uniform individual pieces of various protective clothing into an abstract carpet as in "Seen".

Simply beautiful in a pleasing sense Karlo's works are never, though they are vital and conceptually sophisticated. They conceal their narrative in

të ndryshme mbrojtëse në një qilim abstrakt si në veprën “Seen”.

Në kuptimin e këndshëm, veprat e Karlos nuk janë thjesht të bukura edhe pse janë jetësore dhe konceptualisht të sofistikuara. Ato e fshehin rrëfimin në mënyra dhe shenja të paqarta, që sjellin materialitetin dhe historinë e tyre në vepër dhe e ruajnë atë përbrenda tyre. Në këtë kuptim, shumë prej veprave të tij ndërlidhen me konceptin e arkivit. Ato janë koleksion i objekteve specifike të cilat përmbajnë dëshmi historike, siç janë letrat e punëtorëve në veprën “The Moon” ose mbishkrimet e të burgosurve në serinë “The History of Misery” që kontribuojnë në rishqyrtimin e mëvonshëm, theksi i të cilit vihet tej përtej gjërave konkrete.

Veprat e Karlos janë si njolla problematike ku përvoja e trazirave shoqërore, dhunës dhe historisë përjetohet nga këndvështrimi i dikujt që vë në pikëpyetje vetë-dëshminë ose mungesën e dukshme të alternativave të këtyre proceseve. Ai e sheh aktive kudo këtë farë të çuditshme, duke shpalosur efekte të papritura në distanca të mëdha kohore. Mu ashtu si e tashmja jonë që po mbjell farat të cilat do ta formësojnë jetën e fëmijëve tanë dhe brezave të ardhshëm.

Cilat do të jenë pasojat e mënyrës sonë të tanishme të të bërit biznes pas disa dekadash—apo ndoshta edhe disa muajsh—të ndryshimit të qyteteve dhe peisazheve, të lidhjes dhe prishjes së kontratave? Çfarë do të thotë kjo për të qenit bashkë, për të dobëtit, për të pambrojturit, për format e tjera të jetës? Në këtë ekspozitë, veprat rriten nga farat e çuditshme të kohërave të shkuara. Arkivimi i objekteve të gjetura, dëshmitë historike dhe përdorimi i objekteve të gatshme janë një fillesë në veprën e Fatmirit, ashtu si janë shfaqjet dhe intervenimet e tij në hapësirat publike, nga të cilat kanë dalë disa nga objektet që prezentohen në “Strange Seed”. Realiteti i tyre transformohet në hapësirën e ekspozitës, por vazhdon të mbetet situativ teksa aktivizohet dhe fton shikuesin të ngjitet në piedestalin e monumentit.

Karlllo e përshkruan veten si një farë e çuditshme. Me sa duket, ai nuk mund të rritet si çdo lulediell tjetër në fushë. Ai e mban kokën në një drejtim tjetër, duke e parë botën ndryshe dhe duke marrë energji dhe lëndë ushqyese të pazakonta nga toka. Ky pozicion, nga një anë çoroditës, shpeshherë rezistues dhe provokues, është edhe dhuratë në të njëjtën kohë, sepse si farë e çuditshme që del tej fushës, artisti arrin t’i shpreh të fshehtat e realitetit nën maskë. E natyrisht, artisti nuk është e vetmja farë e çuditshme – sepse ekspozita na tregon se bota është e mbushur me përplot fara të çuditshme. “Strange Seed” është ekspozitë që lidhet me dëgjimin, e nxitur nga letrat e kërkesave të punëtorëve shqiptarë drejtuar eprorëve të tyre, nga mbishkrimet

ambiguous situations and signs, which in turn bring their own materiality and history into the work and preserve it within it. In this sense, many of Karlo's works are related to the concept of the archive. They are a collection of specific objects that contain historical testimony, such as the letters of the workers in 'Moon' or the inscriptions of the prisoners in the series "The History of Misery", and contribute to a late re-examination that points far beyond the concrete things.

Karlo's works are trouble spots where the experience of social upheaval, violence and history can be experienced from the perspective of someone who questions the self-evidence or apparent lack of alternatives of these processes. Everywhere he sees this strange seed at work, unfolding unexpected effects over great temporal distances. Just as our present is sowing the seeds that will shape the lives of our children and future generations.

What will the consequences of our current way of doing business, of changing cities and landscapes, of making and breaking contracts be in a few decades or maybe even a few months? What does it mean for our togetherness, for the weak, for the vulnerable, for other forms of life?

The various works in this exhibition grow from the strange seeds of times gone by. The archiving of found objects, historical testimonies and the use of ready-made objects is a strand in Fatmir's work, as are his performances and actions in public spaces, from which some of the objects shown in 'Strange Seed' have emerged. Their reality is transformed in the exhibition space, but remains situational as it activates and invites the viewer to climb onto the pedestal of the monument.

Karlo describes itself as a strange seed. Seemingly unable to grow like any other sunflower in the field, it stretches its head in a different direction, looking at the world differently and absorbing unusual energies and nutrients from the soil. This position, on the one hand perverse, often resisting and provocative, is at the same time a gift, because as a strange seed sticking out of the field, the artist finds an expression for the hidden, the reality under the mask. But of course, the artist is not the only strange seed - the exhibition shows that the world is full of strange seeds.

"Strange Seeds" is an exhibition about listening, triggered by the pleading letters of the Albanian workers to their superiors, by the inscriptions of the prisoners in Rankovic's dungeons, or by the mountains of rubble torn out of the asphalt - a time stored in the grey coating that suddenly lies before us in huge fragments. The exhibition shows the artist diving between the layers of

e të burgosurve në birucat e Rankoviçit, ose nga malet e rrënojave të nxjerra nga asfalti - si kohë që është ruajtur në një shtresë gri, e që befas shtrihet para nesh në fragmente të zgjeruara. Ekspozita na prezenton artistin që zhytet mes shtresave të asfaltit, duke kërkuar atje jetën, për veten dhe farën e çuditshme që është jeta – ashtu siç e sheh ai.

Në rrugën Prishtinë-Shkup, qyteti shtrihet derisa të arrijë në kufi. Në disa vende rruga është prishur nën peshën e kamionëve dhe pjesë të tëra të saj rrëshqasin poshtë kodrës. Rrugës shihen dyqane të vogla, të tilla që shesin gjithçka që nevojitet për të ndërtuar kantiere dhe shtëpi, punëtori, blloqe apartamentesh, komunitete të mbyllura për të pasurit dhe rrallëherë ka ndonjë copë toke bujqësore. Aty ku rruga është e dëmtuar, shfaqet dhe i gurtë. Në një kodër pranë kufirit maqedonas gjendet një varrezë e madhe e UÇK-së, e rrethuar me mure guri dhe kulla, si një fortesë. Pas saj shihen disa fusha, të cilat tani përdoren për të ruajtur gurët, makina të panumërta të shkatërruara, midis restoranteve, hoteleve, salloneve të masazhit dhe shtëpive të reja pa banorë. Te disa nga ndërtesat e vjetra ende shihen vrimat e plumbave të rastësishëm nga lufta. Por shkatërrimi i paqes mbizotëron, edhe pse çdo shtëpi, çdo sallë, çdo kioskë është një shpresë për një jetë të re, një vend për familjen, një dëshmi e përpjekjes dhe një mall për jetesë më të sigurt. E njëzet vjet më parë, fusha të mëdha luledielli rreshtoheshin rrugës. Progresi, në vetvete, është një farë e çuditshme. Ai mbin në forma që asnjëri se pret. Artisti Fatmir Mustafa-Karillo ka përjetuar luftën, shpërnguljen, humbjen e shtëpisë dhe familjes, varfërinë në Perëndimin e pasur dhe fuqitë e reja në Lindjen e vjetër.

Kopertina e ekspozitës tregon gjurmën e një dore në një pëlhurë të bardhë pambuku. Qartazi, dora që fshiu djersën nga trupi me këtë leckë ishte dora e një punëtori. Dy fotografitë në pjesën e përparme të dhomës së dytë tregojnë një nga këta punëtorë duke përdorur leckën në qytetin shqiptar të Elbasanit. Kjo leckë është jeta që Fatmir Mustafa-Karillo po e prezenton në kohë. Kundër zërit dekurajues, që kthjelltas flet nga muret e galerisë, me shkronja neoni: “It’s Difficult, You Better Stop it”. Vetëm arti mund ta ndëgjojë këtë thirrje e prapë se prapë të vazhdojë ta bëjë këtë gjë.

Mendimet janë si farat. E të tilla janë edhe veprimet njerëzore apo ngjarjet e papritura që intervenojnë në biografitë e njerzve dhe i nisin ato në shtigje të reja, shpeshherë të panjohura. Këto fara shpesh shumohen te njerëzit dhe mendimet e tyre ndër breza dhe pas njëfarë kohe është e vështirë ta kuptosh se prej nga kanë ardhur, kush i solli dhe çfarë u bë me to, sepse tashmë janë bërë shumë normale për t’u vënë re. Përveç nëse, natyrisht, i vëreni, ashtu si farat e çuditshme të cilat Mustafa-Karillo i bën të mbijjnë në ekspozitën e tij.

asphalt, searching for life there, for himself and the strange seed that is real life as he sees it.

On the road from Pristina to Skopje, the city does not stop until it reaches the border. In some places the road is buckling under the weight of the lorries, whole sections of it are sliding down the hillside. Small shops line the road, shops selling everything needed for building sites and houses, workshops, apartment blocks, gated communities for the rich, and rarely is there a patch of farmland. Where the road is torn up, stony earth appears. Near the Macedonian border, on a hill, there is a large UCK cemetery. It is surrounded by stone walls and corner towers, like a fortress. Behind it are former fields, now used to store stones, countless wrecked cars, sorted by carcass, interspersed with restaurants, hotels, massage parlours and new houses with no occupants.

The few old buildings still have the occasional bullet hole from the war. But the destruction of peace prevails, even though every house, every hall, every kiosk is a hope for a new life, a place for the family, a testimony to hard work and a longing for security. Only twenty years ago, large fields of sunflowers lined the road. Progress itself is a strange seed. It germinates in ways that no one expected. The artist Fatmir Mustafa-Karullo has experienced war, displacement, loss of home and family, poverty in the rich West and the new powers in the old East.


The cover of the exhibition shows the imprint of a hand on a white cotton cloth. Obviously, the hand that wiped the sweat from its body with this cloth was the hand of a manual worker. The two photographs at the front of the second room show one of these workers using the cloth in the Albanian town of Elbasan. This cloth is the life that Fatmir Mustaffa-Karullo is passing on through time. Against the voice of discouragement that speaks brightly from the walls of the gallery in neon letters: "It's difficult. You better stop". Only art can hear in these sentences the incentive to do it anyway.

Thoughts are seeds. So are human actions or unexpected events that intervene in people's biographies and set them on new, often unexpected paths. These seeds often multiply in people and their thoughts over generations, and after a while it is hard to tell where they came from, who brought them, and what became of them, because they have become too normal to be noticed. Unless, of course, you notice them, like the strange seeds that Mustafa-Karullo makes sprout in his exhibition.

SANTITA PA

7 II - 30 - III









02

02.

The History of Misery (Part I)
(Last Touch of the Milky Way)
2019 – 2023

Installation view,
National Gallery of Kosovo

The History of Misery (Pjesa I)
(Prekja e Fundit e Rrugës së Qumështit)
2019 – 2023

Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovës

^

Foto/Photo: Atdhe Mulla

>







03

03.

Nightmare Collection
(Canvas, paper, asphalt, photo print)
2019 – 2023

Installation view,
National Gallery of Kosova

Koleksion "Nightmare"
(Kanvacë, letër, asfalt, foto print)
2019 – 2023

Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovës



^

Foto/Photo: Enver Bylykbashi

>



Komiteti Metalurgji "Cetta, Pava"
 Minies se S.S.K.S.T
 (Kopje si Sudriti)
 C. Beson

KERKES

Unë i quajteri Sulip Laçi, i biri Shemsetdit
 dhe i Sadit, i datëlindur si dritor 1948, lindur
 dhe bënë në shtetin shqiptar, i natës
 Ebeson, parashikoj të ardhur tuje si me fondit:
 Kam kryer klasën e 8 (tetë) të lirisit të
 lirisit dhe prej 1.4.1980 punoj pranë agjencisë
 së Shtetit me profesione punëtor i kategorisë
 së parë Gate leshj periudha që punoj në
 unë të Shtetit jam munduar të punoj me
 ndërgjegje, disiplinë e frymë të lirisit, ku ka
 qenë nevoja e nevojshme.
 Jam munduar të përveçes; preferanca për
 unë këtë uptonuar dhe i udhëj veten të
 aftë për atëtim.
 Mëkrijet tija; kërkesë, i detyrohem detyrohem,
 që depër në kuadrit të tija; unë që të më
 jepin të drejtën për të lirisit në komisionin
 të atëtimit për të marrë kategorinë e dytë, që
 të atëtohem punëtor shtetë.
 Mëkrijmë një shprehje në kërkesë unë
 do të merret në konsideratë.
 Me respekt
 (Sulip Laçi)

15.3.1982

Lutje

Unë e nënshkruara Arjana Balashi
 parashikoj lutjen time si më poshtë vijon:
 Jam punonjëse e uzinës korso-kimike reparti
 kimik.
 Kam fituar punën më dt. 30.12.1980
 teknologje me kategorinë e parë.
 Vazhdoj shkollën e mesme të përgjithshme
 viti dytë.
 Kam ndjekur vazhdimisht kurset e kualifikimit
 dhe jam munduar të njëjtëfshihetate profesio-
 nit të punës.
 Gratoj i lutem komisionit dhe depër së
 kuadrit të më jepin të drejtën për tu
 atëstuar në këtë profesion për të fituar
 kategorinë e dytë.
 Mëkrijmë një shprehje se komisioni do
 merret në konsideratë kërkesën time

Me respekt
 Arjana Balashi

16.10.1982

04.

The Moon
 (Bottle, request letters)
 2014 - 2023

Installation view,
 National Gallery of Kosova

"The Moon"
 (Shishe, letra të kërkesave)
 2014 - 2023

Pamje e instalimit,
 Galeria Kombëtare e Kosovës









05

05.

Seen
(Worker's clothes, carpet frame)
2023

Installation View,
National Gallery of Kosova

Seen
(Roba të punëtorëve, kornizë tapeti)
2023

Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovë

^

06.

Sweat Tissues
(Installation box, glass,
wood, cotton fabric)
2014

Installation view,
National Gallery of Kosova

Sweat Tissues
(Kuti instalacioni, shishe,
dru, pëlhurë pambuku)
2014


Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovës

06









07

II.

07.

Anyways, Always
(C-print)
2011 – 2023

Installation view,
National Gallery of Kosova

Anyways, Always
(C-print)
2011 – 2023

Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovës

32 – 33



07.

Anyways, Always
(Marble)
2011 – 2023

Installation view,
National Gallery of Kosova

Anyways, Always
(Mermer)
2011 – 2023

Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovës



^

IT'S DIFFICULT
YOU BETTER STOP IT

08.

It's difficult,
You Better Stop it
(Neon wall installation)
2023

Installation view,
National Gallery of Kosovo

It's Difficult,
You Better Stop it
(Instalacion neoni në mur)
2023

Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovës

< Foto/Photo: Atdhe Mulla

v

08




09.

The History of Misery (Part Two)
(Photo with backlight, curtain,
phosphorescent writing)
2019 – 2023

Installation view,
National Gallery of Kosovo

Foto/Photo: Atdhe Mulla



09

The History of Misery (Pjesa Dy)
(Foto me dritë prapa, perde,
shkrim fosfoeshent)
2019 – 2023

Pamje e instalimit,
Galeria Kombëtare e Kosovës

Ukaj ALI
6 VII 1959
KADAS
HA DAR

1959
20-4

PROJ. HISTORIT
SALIA. BANAS
UPDUL RTU
3-11-1963

77 02

[RIZ]

SARITIM - BROC NQOFT
SENE HIXMA MAT VOGEL
PUNUE
YEDSLANS
KERKUE
ME

2E-1143
#

ENVER

IRFAN BUENA
05-14-11-64
20-53

HAKI
NECIAT
SURO

01

Skulptura “The Artist Must Stand” në hyrje të Galerisë Kombëtare, e cila daton prej periudhës së koronës, është tema kryesore e ekspozitës: e cila shfaq bazën e monumentit, por në vend të skulpturës që do duhej të ishte përmbi, mbi të janë vendosur vetëm dy rrota mbështetëse të vogla prej guri, sikur të atyre biçikletave të fëmijëve. Gjatë periudhës së koronës, kishte ndryshuar dhe gjendja e artistit: çfarë roli luan arti në një shoqëri që karakterizohet nga izolimi social, kriza ekonomike dhe pasiguria politike? Ajo që dukej normale papritur ishte bërë e brishtë. Në një mënyrë, shprehet Karlo “ka gjithmonë njëfarë pandemie në shoqërinë tonë - Kosova është e izoluar, pasiguria është gjithmonë prezente dhe nuk mbaron kurrë”. Në këtë situatë, monumenti është një inkurajim për të besuar. Në të njëjtën kohë, ky monument pa heronj është një ftesë për t’u ngjitur në pedestal dhe për të marrë pozicionin e artistit. Rrotat e vogla stërvitore i referohen faktit që artistët, si shumica e njerëzve, janë në një rrugë të cilën mësojnë si ta ecin teksa vazhdojnë. Ata përballen me frikën dhe pasigurinë, si fëmijët për të cilët rrotat e stërvitjes ofrojnë një masë sigurie. Është një përshëndetje e papritur që nga fëmijëria për botën e të mëdhenjve, që e njuh brishtësinë e pozicionit të heronjve dhe i lejon të rriturit e mençur të mbeten fëmijë në momente të caktuara.

The sculpture ‘The Artist Must Stand’ in the square in front of the National Gallery, dating from the Corona period, acts as a leitmotif for the exhibition: it shows the base of a monument, but instead of the sculpture standing on it there are only two small, stony support wheels, like those on a child’s bicycle. During the Corona period, the artist’s situation also changed: what role does art play in a society marked by social isolation, economic crisis, and political uncertainty? What seemed normal suddenly became fragile. In a way, says Karlo, “there is always a kind of pandemic in our society - Kosovo is isolated, the uncertainty never ends”. In this situation, the monument is an encouragement to trust. At the same time, this monument without heroes is an invitation to step onto the pedestal and take up the position of the artist. The small training wheels refer to the fact that artists, like most people, are on a path that they learn to walk as they go. They are confronted with fear and uncertainty, like children for whom training wheels provide a measure of security. It is an unexpected greeting from childhood to the world of the great, which knows the fragility of the heroes’ position and allows wise adults to remain children at certain moments.

02

Në dhomën e parë të guidës, shihet gjeneratori Van de Graaff. Sfera e tij metalike ju fton ta prekni atë. Pajisja mund të prodhojë tensione të larta relative me mjedisin, të cilat në disa aplikime mund të shkarkohen në rrufe ose, si në këtë rast, thjesht t’u ngrihen flokët. Gjeneratori është pjesë e instalacionit “The History of Misery” që hap guidën dhe e mbyll në një dhomë tjetër në fund të ekspozitës. Në shtresën e bardhë të bojës në muret e hyrjes, ka gdhendje mezi të dukshme që tregojnë

In the first room of the tour, there is a Van de Graaff generator. Its metallic sphere invites you to touch it. The device can produce high voltages relative to the environment, which in some applications can discharge into lightning or, as in this case, simply make people’s hair stand on end. The generator is part of the installation “The History of Misery” that opens the tour and closes it in another room at the end of the exhibition. In the white layer of paint on the walls of the entrance, there are

- > kopje të emrave, datave ose mesazheve të lënë nga të burgosurit në qelinë e tyre pa dritë, të burgut lokal, gjatë të ashtuquajturës periudhë Aleksandër Rankoviç.

barely visible carvings showing copies of names, dates, or messages left by prisoners in their lightless cell of the local prison during the so-called Alexander Rankovic period.

03

Piktura e madhe “Rapid Eye Movement” dhe skulptura e ndërlidhur e asfaltit “Self-portrait” i përkasin grupit të veprave “Nightmare” të cilat në shumë mënyra i referohen materialit të asfaltit. “Pllakat e asfaltit” thotë Karlo, “përmbajnë shtresa të regjimeve dhe sistemeve të ndryshme, nga ato të shtruara gjatë kohës së Jugosllavisë socialiste, të periudhave të ndryshme para dhe pas luftës së Kosovës të vitit 1999, deri në ato para dhe pas pavarësisë së Kosovës. Asfalti është përdorur për zgjedhje, për pasuri dhe për të lidhur fshatrat e largëta me jetën e qytetit. Trotuari është mpiksja proverbiale e kohës, një relikë mbi të cilën shtrohen vazhdimisht shtresa të reja. Ku jam unë dhe komuniteti im midis këtyre shtresave?” pyet Karlo, duke hapur një sirtar mes shtresave të regjimeve gjithnjë në ndryshim në veprën e tij “Self-portrait” (2020). Në dollap gjindet fotografia e vetme e fëmijërisë e artistit dhe albumet familjare të cilat u dogjën gjatë luftës në Kosovë. Sipërfaqja e pikturës “Rapid Eye Movement” është e mbuluar me pluhur pigmenti nga shtresa të ndryshme kohore, i hedhur mbi telajo nga asfalti nga një frezë dore. “Piktura është veç pluhur.” Tronditja e këtij vështrimi në histori i dha veprës titullin, duke aluduar në lëvizjet e syve në ëndrra. Krahas pikturës nr. 2 nga cikli “Nightmare” dhe skulpturës “Self-portrait”, gjindet një fotografi e një grumbulli rrënojash të asfaltit, jo larg Prishtinës, i cili është edhe burimi i materialit për këtë grup veprash.

The large-scale painting “Rapid Eye Movement” and the related asphalt sculpture “Self-portrait”. belong to the ‘Nightmare’ group of works, which refer in various ways to the material of asphalt. “Slabs of asphalt,” says Karlo, “containing layers of different regimes and systems, from those paved during the times of socialist Yugoslavia, through various periods before and after the Kosovo war of 1999, to those before and after Kosovo’s independence. Asphalt has been used to fight elections, make fortunes, and connect distant villages to the life of cities. The pavement is the proverbial clot of time, a relic over which new layers are constantly being laid. Where am I and my community among these layers?” asks Karlo, opening a drawer between the layers of ever-changing regimes in his work “Self-portrait” (2020). It contains the artist’s only childhood photograph and the family albums which were burned during the Kosovo war. The surface of the painting Rapid Eye Movement is covered with pigment dust from different layers of time, thrown onto the canvas from the asphalt by a hand-held milling machine. “The painting is just dust.” The shock of this glimpse into history gave the work its title, alluding to the eye movements in dreams. Alongside painting no. 2 from the “Nightmare” cycle and the “Self-portrait” sculpture, there is a photograph of a pile of asphalt rubble not far from Pristina, the source of the material for this group of works.

04

Grupi i veprave “The Moon” karakterizohet nga kushtet e punës dhe të jetesës së punëtorëve

The “Moon” group of works is characterized by the working and living conditions of the

>

në një punishte çeliku të ndërtuar nga Bashkimi Sovjetik në qytetin shqiptar të Elbasanit gjatë regjimit autoritar të Hoxhës. Tri kutitë e dritave në pjesën e përparme shfaqin një sërë shishesh historike pijesh me gaz nga sallat e prodhimit, tashmë të braktisura në Elbasan. Secila prej këtyre shisheve shqiptare të prodhuara në masë ka një ngjyrë dhe patinë të ndryshme nga grimcat toksike të fabrikës së çelikut. Ato formojnë një tablo abstrakte në të cilën çdo pjesë duket si një ekzemplar i çmuar, unik, edhe pse dikur shtrihej në rrënojat e historisë së fabrikës. Vitrinat anash përmbajnë peticionet e punëtorëve elbasanas të cilët pinin nga këto shishe. Shpesh, letrat e tyre drejtuar eprorëve të tyre shpalosin dëshirën për t'u transferuar në një departament tjetër ose për t'u avancuar. Në vendngjarje, në Elbasan, Karlo mësoi se arsyeja kryesore e këtyre kërkesave ka mundur të jetë arsyeja se ambienti ku ata punonin ishte shumë toksik dhe jo i shëndetshëm. Në përgjigje të këtyre kërkesave, përgjegjësit shënonin çdo herë në fletë: Jo, ose shumë pak prej tyre me një Po.

05

Qilimi është i ndërtuar nga copa të ndryshme të veshjeve dhe uniformave mbrojtëse të punëtorëve. Është shumëngjyrësh, po në të njëjtën kohë është më shumë se thjesht dekorim apo një tapet i gatshëm shumëngjyrësh. Kjo vepër është tapet identitetesh. Duket shumëngjyrëshe, por të ecësh në të, vërtet do të ishte ndjenjë e çuditshme. "Seen" problematizon të drejtat e punëtorëve në Kosovë, të cilët kanë pak të drejta, nuk kanë orar të mbrojtur të punës dhe punojnë pa kontrata. Sidoqoftë, janë këta punëtorë që e mbajnë shtetin gjallë. Puna e Karlos i "sheh" ata dhe njëkohësisht titulli i veprës të kujton lajmërimin në aplikacion në smartphone kur dërgohet një mesazh teksti dhe statusi i tij raportohet si "seen" kur mbetet pa përgjigje.

workers in a steelwork built by the Soviet Union in the Albanian town of Elbasan during the authoritarian Hoxha regime. The three light boxes on the front display a series of historic soda drinks bottles from the now-abandoned production halls in Elbasan. Each of these mass-produced Albanian bottles has a different color and patina from the toxic particulate matter of the steel mill. They form an abstract tableau in which each piece looks like a precious, unique specimen, even though it lay in the rubble of the factory's history. The display cases on the sides contain petitions from the Elbasan workers who drank from these bottles. Often, their letters to their superiors tell of a desire to transfer in another department or to be advanced. On the spot in Elbasan, Karlo learned that the main reason for these requests could be that the environment they were working in was very toxic and unhealthy. In response to these requests, those in charge made a note on the sheets each time: No or very few with a Yes.

The carpet is made up of uniform pieces of various workers' protective clothing. It is colorful and at the same time more than just decoration or a colorful ready-made. This work is a carpet of identities. It seems colorful, but to actually walk on it would be strange. "Seen" problematizes the rights of workers in Kosovo, who have few rights, protected working hours, and contracts. Yet it is these workers who keep the country running. Karlo's work "sees" them, and at the same time, the title of the work is reminiscent of the display in the news application on a smartphone when a text message is sent and its status is reported as "seen" without a reply.

06

Të shkujdesura dhe të lehta, disa lecka rrijnë pezull në një kuti qelqi, teksa krijojnë një jetë të qetë të objekteve kalimtare, mu si gjethet në hapësirë. Ky instalacion u krijua si pjesë e punës së Karlos për projektin e “The Moon” në punët e mëparshme të çelikut të Elbasanit. Sot uzina është një gërmadhë industriale dhe askush nuk punon më aty. Nëpër rrugët e qytetit të afërm, Karlo u kërkoi punëtorëve të fshinin djersën me lecka të bardha pambuku, të cilat ai ua kishte dhënë dhe më pas i kishte ruajtur për vete. Fotografitë e punëtorit në pjesën e përparme të sallës kapin këtë moment. Në instalimin origjinal, aroma e leckave ishte e pranishme përmes një vrime në xhami, e cila më vonë do të shndërrohet në një parfum në vete. Në instalacion transmetohen proceset performative, shëtitja e artistit nëpër qytet, bisedat me punëtorët dhe procesi i tharjes së djersës në trup. Në të njëjtën kohë, ajo korrespondon me mbishkrimet e ndriçuara “It’s Difficult, You Better Stop it”, të cilat befaskan kalojnë nga sfera e përvojës së artistit në sfidat e punës së përditshme të shumë njerëzve.

Airy and light, several tissues float in a glass box, creating a still life of ephemeral objects like leaves in space. The installation was created as part of Karlo’s work on the Moon project at the former Elbasan steelworks. Today the plant is an industrial ruin and no one works there. Karlo asked workers on the streets of the nearby town to wipe their sweat with white cotton cloths, which he handed to them and then preserved. The photographs of the worker at the front of the hall capture the moment of wiping. In the original installation, the smell of the cloths was present through a hole in the glass, which will later be transformed into a perfume of its own. The performative processes, the artist’s walk through the city, the conversations with the workers, and the process of drying the bodies of sweat are transmitted in the installation. At the same time, it corresponds to the illuminated inscriptions “It’s Difficult” and “You better Stop it”, which abruptly move from the realm of the artist’s experience to the challenges of many people’s daily work.

07

Në bustin e mermerit të Fatmir Mustafa Karlos ku artisti pozon si Elvis Presley, shihen te transferuara pamje te videove nga vepra e viteve 2011-2012 Why Don’t You Speak Finnish. Karlo, asokohe 27 vjeç, jetonte në Finlandë si një emigrant i varfër në periferi të shoqërisë. I përballur me sulme ksenofobike, ai i trajtoi këto fenomene në tekstin e tij Go Away Al-Quaida Nigger. Kësisoj, kjo situatë e jetesës e çoi atë në shoqërimin e njerëzve të pastrehë dhe të varur nga droga, në një qendër finlandeze të mirëqenies. I tronditur nga mjerimi dhe pashpresa e rutinës institucionale të qendrës shtetërore të mirëqenies, ai iu përgjigj situatës me një ndërhyrje që e lejoi të intervenonte në rrethanat e tij si një person i bllokuar në këtë

